



Takim me artistin Rexhep Iseni

Arti i shndërruar në vepër



Veprat e tij janë blerë nga shumë ndërmarrje me renome, institucione shtetërore dhe galeri. Rexhep Iseni pati sukses të arrijë majat e kulturës figurative dhe me opusin e tij të pasur artistik të lë gjurmë në pikturë

Në mesin e fituesve të sivjetmë të çmimit më të lartë shtetëror "23 Oktomvri", që ndahet me rastin e Ditës së Luftës revolucionare të Maqedonisë në sferën e kulturës, është edhe pensionisti 77 vjeçar nga Mateçi, Rexhep Iseni. Ai ka mbaruar Akademinë e artit figurativ në Shkup në klasën e Vangell Kox-

homanit. Është anëtarë i SHAFM dhe SLUJ, ka realizuar një numër të ekspozitave të pavarura dhe grupore, është fitues i shumë çmimeve dhe mirënjohjeve, mes të cilave edhe çmimet "Tutunoberaçi" (Prilep) dhe "11 Noemvri" (Kumanovë). Ai ka marrë pjesë edhe në Osten Binalen 2012 me katër vizatime në performancë grafike. Prej vitit 2013 vazhdimisht ekspozon në Shtëpinë e kulturës në Kumanovë, në ekspozitë grupore me piktorë e pensionistë të qytetit. Veprat e tij janë blerë nga shumë ndërmarrje me renome, institucione shtetërore dhe galeri. Rexhep Iseni pati sukses të arrijë majat e kulturës figurative dhe me opusin e tij të pasur artistik të lë gjurmë në pikturë.

Përndryshe, Iseni është njeri modest dhe nuk ka dëshirë të flasë shumë për sukseset e tij, edhe pse është një shembull i bukur se edhe në gjeneratën e tretë mund të jesh i suksesshëm dhe i dobishëm si për familjen, ashtu edhe për Shoqatën e pensionistëve të Kumanovës, por edhe më gjerë për tërë shoqërinë. Ai thotë se nuk ka shpresuar që do të fitojë çmimin, por për të është një nder i madh, obligim dhe nxitje për të vazhduar edhe më tutje të krijojë vepra artistike. Në atelienë e tij, ai ndihet më së miri, por ka dëshirë të jetë i rrethuar edhe me më të afërmit, ndërsa më të rinjve u sugjeron që të përdorin talentin e tyre në cilëndo sferë dhe se suksesi do të vijë vetvetiu.

Takimi i fundvitit bën bashkë pensionistët e Tetovës

Rreth 400 pensionistë, anëtarë të shoqatës tetovare, kanë marrë pjesë në takim të përbashkët, i cili u mbajt me 26 nëntor. "Përmbyllim një vit të suksesshëm në të cilin i realizuam të gjitha planifikimet e parapara në programin për punë. Kishim shfaqje të suksesshme në lëmin e sportit, jetën kulturo-shoqërore, morrëm pjesë në takime me pensionistët, në evenimente tradicionale, organizuam pushime të suksesshme në det dhe në banjë. E gjithë kjo është nxitje të vazhdojmë me sukses të punojmë edhe në të ardhmen", theksoi Stojan Sokolovski, kryetar i Kuvendit dhe Shaban Azizi, kryetar i bordit ekzekutiv të shoqatës. Argëtimi dhe shoqëria e pensionistëve ishte me të vërtetë e paharrueshme. Kjo është një nga format që i trajton Shoqata e pensionistëve Tetovë dhe duke marrë parasysh interesin, mbetet që kjo të vazhdohet edhe në të ardhmen. Pensionistët me të vërtetë argëtoheshin në lojrat dhe këngët me karakter të ndryshëm kombëtar, si mundësi për shoqërim të përbashkët. Ky ishte shembull i vërtet për bashkëjetesë. Pjesë e kësaj ngjarjeje, si dhe në seancën e Kuvendit të Shoqatës të mbajtur më 23 nëntor vitin 2016, ishte dhe TTK Banka me prezantim para anëtarëve të pranishëm, duke u vënë theks të veçantë kushteve atraktive për ofertë e kredisë konsumatore dhe banesore, duke marr pjesë me stendë dhe materiale promovuese nga spektri i gjerë i produkteve dhe shërbimeve të cilat i ofron Banka, për të ndihmuar standardin dhe cilësinë e pensionistëve dhe familjeve të tyre të jetë më i lartë dhe më mirë. Me kënaqësi për të gjithë, ahengu dhe miqësia zgjatën më shumë se pesë orë.

Vazhdon realizimi i projektit "Super Mario"

Së fundmi në shtëpinë e të moshuarve "Kiro Krsteski - Platnik" në Prilep për herë të katërt u nënshkrua, gjegjësisht vazhdoi kontrata për projektin "Super Mario", midis këtij institucioni dhe autoriteteve lokale të qytetit. Ky është një projekt unikat në nivel të Maqedonisë, i cili funksionon sipas standardeve evropiane. Projekti ka filluar para 4 viteve. Në të janë të kyçur 13 vullnetarë, të cilët kujdesen për rreth 100 persona të moshuar, për të cilët nuk ka kush të kujdeset, ose të afërmit apo fëmijët e tyre nuk janë në Prilep dhe nuk mund shpesh t'i vizitojnë. Vullnetarët i vizitojnë personat e moshuar disa herë në javë, ju blejnë sende ushqimore, barna, paguajnë faturat e tyre, ua rregullojnë shtëpinë, por thjeshtë edhe shoqërohen dhe bisedojnë me ta. Për vitin tjetër është parashikuar të zgjerohet ky projekt me më shumë mjete, të ketë edhe më shumë vullnetarë, kurse dhe numri i personave të moshuar prej 100 të ritet në 150 ose 200, të cilët do të jenë shfrytëzues të këtyre shërbimeve, theksoi Marjan Nikolovski, kryetari i Prilepit, gjatë nënshkrimit të marrëveshjes së re. Projekti kushton rreth një milion denarë, mjete të cilët janë siguruar nga buxheti i administratës lokale. Ky është një aktivitet mjaft interesant në shënimin e "Javës për kujdesin ndaj personave të moshuar", e cila deri tani ka treguar rezultat pozitiv. Ky është një shembull pozitiv se në kuadër të mbrojtjes institucionale për persona të moshuar, siç ofrojnë shtëpitë për persona të moshuar, ekzistojnë edhe masa jo-institucionale për mbrojtjen e personave të moshuar, të cilat përfshijnë organizimin dhe ofrimin e shërbimeve për të moshuarit në shtëpitë e tyre. Do të ishte mirë në qoftë se një projekt të tillë do të kishte dhe në qytete tjera në vend, ku gjithashtu ka shumë njerëz të moshuar që jetojnë vetëm.

Shoqata e Strugës hap shkollë për shah

"Pasi që u pensionova, menjëherë iu bashkangjita aktiviteteve të SHP Strugë dhe bashkë me kryetarin Milodrag Trposki, admirues i madh i shahut dhe gjykatës shahu, formuam shkollë për lojtarët e rinj të shahut, e cila punon në klubin e pensionistëve. Për arsye se u paraqitën shumë fëmijë, i ndajtëm në dy grupe, ndërsa Shoqata e pensionistëve na siguroi hapsirë, nxemje dhe pajisje shahu. Gjithashtu, mjeshtri internacional në shah për gra Gabriela Koskoska, e cila me prejardhje është nga Struga, ka dhuruar pesë garnitura shahu dhe pesë tabela për nevojat e shkollës dhe shoqatës", thotë mësuesi i shahut, Millço Balltoski. "Shkolla sportive për shah falas, e projektuar për nxënësit e shkollave fillore në Strugë, është sfidë për të gjithë admiruesit e kësaj loje të cilët dëshirojnë të ecin sipas ha-



pave të lojtarëve të famshëm në qytet. Programi për të mësuar është përshtatur për fillestarë, por edhe për ata të cilët tanimë janë avancuar. Luhet për çdo ditë në grupe, varësisht nga moshën. Shkolla e shahistëve është e ndihmuar nga SHP Strugë", thekson kryetari Miodrag Trposki. Shahu si disiplinë ndihmon të fitohet dituri dhe të bëhen lëvizje reale në jetë. Zhvillon

mendimet dhe përqendrimin e fëmijëve dhe ky sport ndikon në zhvillimin e tyre psikologjik. Shahu është një lojë mendore, e cila ka elemente të sportit, artit dhe shkencës. Pikërisht për këtë shkak është formuar Shkolla e shahut, dhe kuptohet në interes të fëmijëve që t'ju jepet mundësi t'i tregojnë njohuritë e tyre, shkathtësi dhe mençuri, por dhe bashkëjetesën.

Pensionistët e Gazi Babës shënojnë 44 vjetorin

Shoqata e pensionistëve Gazi Babë më 16 dhjetor ka shënuar 44 vjetorin e ekzistimit të saj. Në solemnitet kanë marrë pjesë kryetari i LSHPM, Dragi Argirovski, kryetari i lidhjes së pensionistëve të qytetit, Metodija Novkovski, kryetarë dhe përfaqësues të shoqatave të pensionistëve të Shkupit, përfaqësues të udhëheqësive të SHP Strumicë, anëtarë të Këshillit ekzekutiv dhe Kuvendit, degëve, këshillave, komisioneve dhe përfaqësuesve të shoqatave nga shoqatat e pensionistëve të Vranjës nga Serbia dhe Pernik, nga Bullgaria. Pasi që kori pranë shoqatës, nën udhëheqësinë e Millorad Lliq - Rade, ka përmbytur këngën solemne dhe kolazh prej disa këngëve të të korjurave, referat rasti lexoi Gjorgje Andonov, kryetari i Këshillit ekzekutiv pranë SHP Gazi Babë. Në fjalimin e tij ai paraprakisht



përhëndeti mysafirët dhe të pranishmit, duke u dëshiruar shëndet të mirë dhe ditë të bukura pensionistësh, theksoi sukseset më të rëndësishme të shoqatës në shumë sfera, të arritura që nga themelimi i saj, por i gjithë ky sukses si rezultat i bashkëpunimit të suksesshëm me organizatën amë LSHPM, pa të cilën të gjitha këto suksese kanë qenë të pamundura të realizohen. "Me sukseset e tyre,

në të gjitha sferat e veprimtarisë, konsiderohemi si një prej shoqatave më të dinjitetshme dhe shoqatë e pensionistëve për respekt. Ky pietet dhe sukses shumë herë janë vërtetuar edhe në LSHPM dhe organet e saj. Rezultat i kësaj është përkushtimi i mirë organizues, struktura solide kadrovike, ekipimi dhe përvoja jetësore e anëtarëve të udhëheqësive. Kemi vendosur bashkëpunim të mirë me Lid-

hjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë edhe gjatë këtij viti, jemi përfshirë në programin e Lidhjes për shënimin e 70 vjetorit të organizimit të pensionistëve të Maqedonisë dhe çdo aktiviteti ynë është në shenjë të jubileut. Bashkëpunim të mirë kemi edhe me vetëqeverisjen lokale, me shumë shoqata të pensionistëve në Maqedoni dhe jashtë saj", theksoi Andonov. Pensionistët e SHP Gazi Babë i përshëndeti edhe kryetari i SHP Vranje nga Serbia, Miroslava Trajkoviq, ndërsa kryetari i SHP nga Perniku i Bullgarisë, Jordan Diçev, krahas fjalëve të bukura, i dhuroi një dhuratë modeste kryetarit Andonov. Solemniteti kaloi në disponim të bukur dhe gëzime të përbashkëta, për çka kontribuoi edhe muzika e bukur, e cila i ngriti në këmbë dhe në valle të gjithë pensionistët.